



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E VITISË - OPŠTINA VITINA

Pranuar - Pranojshë Mëlbura 19-01-2023

No. i organit (Org. Broj)	Numri i Broj	Shtetësi Prilloj	Vlera Vendosje
02-035/02-56			



**Republika e Kosovës**

**Republika Kosova**

**Republic of Kosovo**

**Komuna e Vitisë**

**Opština Vitina**

**Municipality of Viti/na**

Në bazë të nenit 13 ,17 paragrafi 17.1 pika e të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 në harmoni me nenin 51.1 të Statutit të Komunës së Vitisë Nr. 01-013/491 të dates 21.04.2011,lidhur me nenin 2 të Ligjit për Aftësimin,riaftësimin profesional dhe punësimin e personave me aftësi të kufizuara Nr. 03/L-019 Kryetari i Komunës në bazë të kompetancave dhe autorizimeve që ja lejon ligji bjen këtë:

### V E N D I M

**Për Shpalljen e Vitit 2023 vit të Personave me Aftësi të kufizuara në teritorin e Komunës së Vitisë.**

#### Neni I

Me këtë vendim Kryetari i Komunës shpallë vitin 2023 vit të Personave me Aftësi të Kufizuara.

#### Neni II

Qëllimi i këtij vendimi është përkrahja ligjore dhe institucionale për aftësimin, riaftësimin, nxitjen dhe përgatitjen profesionale për punësim të përshtatshëm për personat me aftësi të kufizuar duke u mbështetur në principet dhe tretmanin e mundësive të barabarta përfshirë edhe mundësitë gjinore.

#### Neni III

Personi me aftësi të kufizuara ka të drejtë në aftësim, riaftësim profesional sipas kushteve të përgjithshme të përcaktuar me këtë ligj. Në rastet e caktuara, kur është e nevojshme për shkak të shkallës, llojit dhe rëndësisë, aftësimi, riaftësimi mund të behët në shkollat e veçanta dhe institucione tjera sipas plan-programeve për aftësimin, riaftësimin profesional.

#### Neni IV

Komuna e Vitisë angazhohet për angazhim maksimal ndaj kësaj ketegorie.

**Neni V**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës së Vitisë.

**Neni VI**

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga ana e Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës

~~Sokol Haliti~~

